

KUVENDI KOMUNAL , HANI I ELEZIT

- Sektori për Planifikim, Urbanizëm dhe Inspeksion -

PROJEKT RREGULLORE

PËR MBROJTJEN E AMBIENTIT NË PNJK HANI I ELEZIT

Hani i Elezit , 2006

**Bazuar në nenin 52.4 pika (e) të Statutit të PNJK-së Hani i Elezit
Sektori për Planifikim, Urbanizëm dhe Inspeksion:**

P R O P O Z O N

Që Bordi i Shefave në njëren nga mbledhjet e ardhshme ta shqyrtoj këtë :

PROJEKT RREGULLORE

PËR MBROJTJEN E AMBIENTIT NË PNJK HANI I ELEZIT

Neni I.

Kjo Rregullore për mbrojtje të ambientit në Kuvendin e PNJK-së, përcakton kushtet e përgjithshme për kryerjen e veprimtarive komunale dhe cakton detyrat dhe detyrimet e qytetarëve, këshillave shtëpiake, bashkësive lokale, ndërmarrjeve private, shoqërore dhe shtetërore, institucioneve, organeve të administrimit të përkohshëm lokal dhe qendror, subjekteve të tjera për mbajtjen e pastërtisë dhe higjienës në fshatra.

Neni 2.

- **Mbajtja e pastërtisë** ; konform dispozitave të kësaj Rregullore nënkupton pastrimin dhe larjen e sipërfaqeve publike me qëllim të largimit të të gjitha llojeve të mbeturinave, borës, fekaleve dhe ujërave të ndotura , gropave septike si dhe mbeturinave të tjera të cilat shkaktojnë ndotjen e ambientit.

-**Rregullimi i ambientit** ; konform dispozitave të kësaj Rregullore , rregullimi i rrugëve, tregjeve, trotuareve dhe objekteve të tjera, largimi i kafshëve të ngordhura nga sipërfaqet publike, si dhe ndërmarrja e masave të tjera të rregullta dhe jashtëzakonshme me qëllim të mirëmbajtjes së pastërtisë dhe higjienës publike.

- **Veprimtarit Komunale** ; konform dispozitave të kësaj Rregullore, konsiderohen bartja dhe pastrimi i ujërave të përgjithshme, bartja e ujërave atmosferike nga sipërfaqet publike, bartja, deponimi dhe përpunimi i bërrilokut, rregullimi dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve gjelbëruese publike në vendbanim.

- **Sipërfaqet publike** ; konform dispozitave të kësaj Rregullore, konsiderohen sipërfaqet e trafikut publik ; stacioni i autobusëve, stacioni i derivateve të naftës, hapësirat e parkingut, sipërfaqet publike të gjelbëruara (parqet, sipërfaqet me barë, sipërfaqet për pushim dhe rekreacion), terrenet argëtuese e sportive, tregjet, hapësirat e hapura midis dhe rreth ndërtesave të banimit kolektiv.

- **Hapësirat tjera** ; konsiderohen ato hapësira që nuk janë hapësira publike, por që shërbejnë për nevojat e ndërmarrjeve, organeve, grupeve të qytetarëve.

- **Gropat septike** ; në kuptim të kësaj Rregullore, konsiderohen gropat për ujësjellës, kanalizim, etj.

Neni 3

Mbajtja e pastërtisë dhe e higjienës Komunale në sipërfaqe

3.1. Për mirëmbajtjen e rrugëve me kanalizime, dhe pa kanalizime, mbi të cilat bëhet trafiku publik, e të cilat shërbejnë për përdorim të përgjithshëm, kujdeset ndërmarrja e kontraktuar, që i ka marrë për sipër.

3.2. Për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe të higjienës publike në trotuare, para ndërtesave të banimit, afariste dhe hapësirave rreth objekteve në të cilat kryhen veprimtari të përhershme ose të përkohshme, kujdesen pronarët përkatësisht shfrytëzuesit e atyre sipërfaqeve dhe objekteve.

3.3. Rrugët duhet pastruar së paku tri here në javë, ndërsa larja e tyre duhet të bëhet 4 herë në javë.

Ndalohet hedhja e letrave dhe mbeturinave të tjera jashtë vendeve të caktuara - shportave, kontejnerëve. Këto mbeturina duhet të hedhen vetëm

në enët e destinuar për këtë qëllim, të cilat i sigurojnë shfrytëzuesit e atyre sipërfaqeve.

3.4. Bërllokun dhe mbeturinat e tjera në rrugë dhe trotuare, ndërmarrja e kontraktuar e ka për detyrë ti largoj. Pastrimi i rrugëve, duhet të bëhet së paku tri herë në javë dhe sipas nevojës në kohën që nuk pengon lëvizjen e kalimtarëve dhe trafikut.

Ndalohej pastrimi i rrugëve në kohën prej orës 7.00 deri ora 22.00 me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme.

3.5. Për pastrimin e borës nga trotuaret para ndërtesave afariste, banesave kolektive kujdesen personat juridik të cilët i shfrytëzojnë, ndërsa për pastrimin e borës nga trotuaret para ndërtesave banesore familjare, lokaleve, kujdesen pronarët dhe shfrytëzuesit e tyre. Ndërmarrjet, këshillat shtëpiake dhe qytetarët e kanë për detyrë, që borën dhe akullin ta grumbullojnë në skajin e trotuarit, ndërsa ndërmarrja e kontraktuar e ka për obligim ta largojë nga trotuari jashtë qytetit.

3.6. Për mbajtjen e pastërtisë dhe higjienës komunale, në hapësirat e parkingut, tregjeve, sipërfaqeve të gjelbëruara kujdeset Ndërmarrja e kontraktuar.

Ndërmarrja e kontraktuar e ka për detyrë që në të gjitha tregjet të siguroj sasi të mjaftueshme të ujit higjienik për freskimin e prodhimeve, dhe pastrimin e tregut, si dhe të ndërtojë numër të nevojshëm të tualeteve, të cilat duhen edhe të mirëmbahen.

Të vendosen kontejnerë të mjaftueshëm për hedhje të mbeturinave të cilat duhet të pastrohen rregullisht çdo ditë tregu.

2. Për mirëmbajtjen e pastërtisë në parqe, në vende me barë dhe sipërfaqe të tjera të gjelbëruara të cilat gjenden në oborre ose mes të ndërtesave banesore, afariste, dhe administrative, si dhe objekte të tjera janë përgjegjës pronarët, përkatësisht shfrytëzuesit e këtyre objekteve ku gjenden.

3.7. Heqja dhe deponimi i bërllokut shtëpiak, mbeturinave, dhe i bërllokut nga sipërfaqet publike, si dhe largimi i fekaleve bëhet nga ndërmarrja e kontraktuar.

Ndërmarrja e kontraktuar e ka për detyrë që rregullisht t'i pastroi enët e bërllokut (kovat, kontejnerët).

Ndërmarrjet, Organizatat, institucionet, e personat e tjerë juridik si dhe qytetarët e kanë për detyrë që të sigurojnë enët përkatëse (shportat ose thasë polivinili) për grumbullimin e mbeturinave, ndërsa vendosja dhe

shpërndarja e enëve të tipizuara (kontejnerët) bëhet nga ndërmarrja e kontraktuar.

Mbeturinat shtëpiake, duhet të grumbullohen në enët e përshtatshme për mbeturina, të cilat duhet të kenë kapakët e tyre, të vendosen jashtë sipërfaqes publike, në vendet e mbrojtura dhe të përshtatshme për bartje ku duhet të mirëmbahen dhe zbrazen rregullisht.

Ndërmarrja e kontraktuar, ka për detyrë që bërlllokun dhe mbeturinat shtëpiake të grumbulluara dhe shfrytëzuesit e shërbimeve, t'i largoi më së paku një herë në javë në kohë të caktuar, kurse nga shitoret dhe dyqanet zejtare e të tjerë, dy herë në javë dhe sipas nevojës.

Organi kompetent i Administratës Komunale, mund në raste të jashtëzakonshme kohore dhe për shkaqe tjera të arsyeshme, të caktoj që në pjesë të caktuara të qytetit, bërllloku, dhe mbeturinat shtëpiake të largohen edhe më shumë herë.

Ndërmarrja e kontraktuar, nuk do t'iu kryej shërbimet e largimit të mbeturinave ndërmarrjeve shoqërore, private dhe publike, institucioneve që nuk janë të pajisur me mjete përkatëse për vendosje të mbeturinave.

Largimi i bërlllokut shtëpiak, fekaleve, dhe ujërave të ndotur nga tualetet e fushës, gropat septike, mund të bëhen vetëm me mjete të destinuara dhe të pajisura për këtë qëllim, për të mos shkaktuar shkapërderdhjen nëpër sipërfaqe publike.

Ndërmarrja e kontraktuar e ka për detyrë që organeve kompetente komunale më së paku për çdo muaj t'iu paraqesë planin e largimit të bërlllokut shtëpiak dhe mbeturinave për muajin e ardhshëm në verifikim.

Në rast se organet kompetente komunale vërejnë ndonjë parregullsi apo neglizhim, në mospërfilljen e duhur të largimit të bërlllokut ,fekaleve dhe punëve të tjera sipas kontraktimit, kanë të drejtë në ndërrimin e ndërmarrjes së kontraktuar.

Neni 4

Gropat septike, kanalizimi dhe gropimi i rrugëve

4.1. Në vendbanimet ku nuk është i ndërtuar rrjeti i kanalizimit, duhet të ndërtohen tualetet higjienike të fushës, nga materiali i caktuar për gropat septike publike, me diametër prej 8 m² dhe duhet të jenë të mbuluara me pllakë betoni, ndërsa vendosen në largësi prej 30 m nga objektet e ujit (puseve) dhe 20 m nga objektet banesore dhe rruga.

4.2. Pastrimi me kohë i tualeteve dhe gropave septike, sipas kërkesës së shfrytëzuesit duhet t'i kryej ndërmarrja e kontraktuar, ndërsa për

mirëmbajtjen e gropave kujdesen ndërmarrjet, organizatat, institucionet e personat juridik, këshillat shtëpiak, përkatësisht pronarët e ndërtesave të cilët i shfrytëzojnë këto gropa.

4.3. Në qoftë se në rrjetin elektrik, ujësjellësit, kanalizimit shkaktohen prishje të cilat shkaktojnë rrezik, ndërmarrjet ose personat e tjerë juridik të cilët mirëmbajnë këto instalime, të gropojnë dhe të rregullojnë menjëherë edhe pa lejen e organeve kompetente.

Ndërmarrjet, bashkësitë, ose personat juridik, të cilët gropojnë ose prishin sipërfaqet publike, pas ndërprerjes së rrethanave objektive, e më së largu në afat prej 3 ditësh t'i drejtohen organit kompetent komunal për marrjen e pëlqimit për kryerjen e punëve dhe caktimin e mënyrës së rregullimit të sipërfaqeve publike.

Neni 5

Kushtet minimale për mbajtjen e pastërtisë në fshatra

5.1. Të gjithë qytetarët, pronarët e ndërtesave familjare të banimit, si dhe pronarët e lokaleve afariste në fshatra, kanë për detyrë ta mbajnë higjienën rreth objekteve të tyre, rrugëve publike dhe objekteve të ujit. Ndërsa, këshilli i vendit të fshatit, mund të kërkoj nga pronarët që brenda afatit të caktuar të pastroj hapësirën rreth objektit të vet dhe ta mirëmbajë.

5.2. Pronarët e lokaleve banesore, afariste, si dhe objektet e tjera duhet të kenë të ndërtuar tualetet, sipas dispozitave higjienike-sanitare larg puseve më së paku 30 m, ndërsa nga ndërtesa tjetër e banimit dhe rrugës më së paku 20 m.

neni 6

Ndalesat

6.1. Me qëllim të mbajtjes së pastërtisë dhe të higjienës Komunale ndalohet:

1.Hedhja e letrave, kartuçave, xhamave ,ambalazhit dhe mbeturinave tjera jashtë enëve për mbeturina.

2.Hedhja e kafshëve dhe shpezëve të ngordhura , mbeturinave tjera nga kafshët dhe shpezët e therura në rrugë, në oborre të afërta dhe sipërfaqe të tjera publike.

3.Çdo lëshim, derdhje e fekaleve nga tualetet dhe derdhja e ujërave të ndotur, në tretuar, rrugë, oborre dhe sipërfaqe të tjera publike.

4.Ndalohet largimi i bërllokut, mbeturinave dhe i fekaleve me mjete që nuk janë të destinuara për këtë veprimtari.

5.Mbajtja e bërllokut dhe e mbeturinave në enë të cilat nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara.

6.Ndotja e fasadave, filtrave, pjesëve tjera të jashtme të ndërtesave dhe të hapësirave tjera punonjëse.

7.Larja e veturave të udhëtarëve, automjeteve bartëse në trotuar dhe rrugë.

8.Shfrytëzimi i sipërfaqeve publike, para lokaleve personale, afariste (trotuarit dhe rrugës) për ekspozimin dhe shitjen e mallrave.

9.Shfrytëzimi i sipërfaqeve të trafikut publik në çfarëdo mënyre.

10.Kryerja e veprimtarisë zejtare në trotuar dhe rrugë.

11.Gropimi i sipërfaqeve publike (trotuarit, rrugës) për çfarëdo qëllimi pa marrjen paraprake të lejes, nga organi kompetent i administratës (lexo nenin 4 pika 4.3).

12.Sharritja, copëtimi i druve, copëtimi i thëngjillit, shkapërderdhja e vajit, dhe e materialit tjetër në trotuare dhe rrugë.

13.Ndalohet hedhja e plehrave të kafshëve në vendet publike në pronësi shoqërore.

14.Shkapërderdhja e armaturës, nëpër sipërfaqe publike (trotuar dhe rrugë) dhe lidhja e armaturës në shtylla druri.

15.Largimi i enëve për mbeturina.

16.Transportimi i materialit ndërtimorë, shkapërderdhës dhe materialit tjetër me automjete që nuk janë të destinuara për këtë transport.

17.Hedhja e pajisjeve shtëpiake të vjetra, e mbeturinave industriale, e ndonjë materialit tjetër si dhe mallit në hapësira të tjera publike.

18.Dalja nga kantieri dhe sipërfaqet tjera të ngjashme të automjeteve në sipërfaqe të trafikut publik, para se ato të pastrohen.

19.Vendosja e përzierësve të betonit në trotuare, rrugë dhe vendosja e materialit ndërtimorë.

20.Lërja e automjeteve të vjetra ose të papërdorshme në sipërfaqet e trafikut publik, në trotuare dhe rrugë.

21.Pjekja e gështenjave, misrit, farave e të ngjashme në trotuare, rrugë si dhe shitja e tyre në trotuare, në oborre të shkollave e në sipërfaqe tjera publike.

22.Ndalimi i zhurmës së tepruar (muzika apo ndonjë lloj tjetër zhurme).

23. Larja e automjeteve, ujitja e kopshteve si dhe rrugëve me ujë të pijes.

6.2. Në sipërfaqe publike ndalohet:

1. Lëvizje jashtë rrugëve dhe rrugicave të caktuara.
2. luajtja, shtrirja dhe ulja jashtë vendeve të caktuara.
3. shkelja dhe shtrirja në karrige të vendosura për pushim në hapësira publike.
4. rrëzimi dhe bartja e karrigeve, nga vendi ku janë vendosur.
5. dëmtimi i luleve.
6. dëmtimi i enëve për mbeturina.
7. ndezja e zjarrit jashtë vendit të caktuar.
8. prerja dhe dëmtimi i drunjve.

6.3. Me qëllim të mbajtjes së pastërtisë në fshatra ndalohet:

1. derdhja, ose shkapërderdhja në këto sipërfaqe e fekaleve të tualeteve, të ujërave të ndotur nga gropat, vendet me bërllok, si dhe në oborret e afërta.
2. shpërndarja e plehut të kafshëve, sanës, materialit tjetër gjatë transportimit.
3. hedhja, lërja e kafshëve dhe shpezëve të ngordhura.
4. hedhja e mbeturinave, letrave , bërllokut nga ndërtesat dhe oborret e veta.
5. hedhja, lërja ose mbajtja e ambalazhit, xhamit të thyer dhe materialet e mbeturinat e tjera.
6. ndezja e bërllokut, gomave, materialit tjetër që bëjnë të ndotur ambientin dhe kushtet e jetës.

6.4. Ndalohet puna e atyre veprimtarive që nuk i plotësojnë kushtet për punë dhe bëjnë ndotjen e ambientit:

1. e pompave të derivateve të naftës,
2. punëtorive të riparimeve të automjeteve,
3. të gjithë atyre veprimtarive prodhuese si: përpunues të drurit, metalit, dhe prodhues të tjerë ndotës,
4. ndërmarrjet ndërtimore,
5. ndërmarrjet industriale,
6. ndërmarrjet transportuese dhe
7. ndërmarrjet për shërbime mekanike.

neni 7

Mbikëqyrja

Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të kësaj rregulloreje e bënë organi i administratës komunale, respektivisht, Sektori për Planifikim, Urbanizëm dhe Inspeksion, ndërsa mbikëqyrjen e bënë Zyrtari apo (Inspektori) komunal për mbrojtje të ambientit.

Neni 8.

Gjobat

8.1. Me gjobë prej 250 deri 500 € do të gjobitet për kundërvajtje ndërmarrja komunale, ndërmarrjet shoqërore dhe private, ndërmarrja publike, organet e administrimit të përkohshëm, entet, shkollat, institucionet e tjera, si dhe personat të tjerë juridik, nëse veprojnë në kundërshtim me nenin 6. të kësaj Rregullore.

8.2 Me gjobë prej 50 deri 250 € do të gjobitet për kundërvajtje qytetarët, personat, dhe pronarët e objekteve hoteliere, tregtarët, dhe zejtarët, veprimtarit e pa varura ekonomike, ose zejtare nëse veprojnë në kundërshtim me nenin 6. të kësaj Rregullore.

8.3 Me gjobë prej 20 deri 50 € e cila arkohet në vendin e ngjarjes (gjoba mandatore), do të gjobitet për kundërvajtje personi fizik, nëse vepron në kundërshtim me nenin 6. të kësaj Rregullore.

8.4 Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë Rregullore, të cilat i shkaktojnë personat e mitur, do të gjobitet personi që kujdeset për te.

Neni 9

Dispozitat kalimtare dhe të fundit

9.1 Për zbatimin e kësaj Rregullore, do të kujdesen Drejtorati për Shërbime Publike me Sektorin e Mbrojtjes së Ambientit, Transportit dhe Ndërmarrja e kontraktuar.

9.2 Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore zëvendësohen Rregulloret e deritashme përkatëse lidhur me Mbrojtjen e Ambientit.

9.3 Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit të Kuvendit Komunal